

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“CONVERSE MANAGEMENT CONSULTING” Sh.p.k. ose CMC Sh.p.k**

Sot më datë 26.Mars 2018, në Tiranë, u mbledhen palët e mëposhtme:

- **Z. Reni Ashiku**, qytetar shqiptar, lindur në Krujë, më 27.08.1978, me vendbanim në Rr. Myslym Shyri, Pallati 124, Ap 13, Tirane, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit nr.029796552 dhe me numër personal H80827056E, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar,
- **Znj. Besarta Dika** qytetare shqiptare, e lindur në Mamurras, Krujë më 1.10.1986 me vendbanim në Rr. “Muzaket”, Pallati Gener 2, kati 5, hyrja 5.1 Tirane, Shqipëri, mbajtëse e letërnjoftimit nr. 029091963 dhe me numër personal 1660010711, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar,

për të formuluar e nënshkruar dokumentin e mëposhtëm:

Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë “Shoqëria”), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti, të cilit i bashkëngjitet si (“Shtojca nr. 1”).

Neni 1 - Emërtimi

Emërtimi i Shoqërisë është Converse Management Consulting Sh.p.k ose shkurtimisht CMC Sh.p.k.

Neni 2 - Selia

Selia e Shoqërisë është në Bulevardi Deshmoret e Kombit, Kullat Binjake Zyra A/1 kati 12-te kulla 2, Tiranë, Shqipëri.

Neni 3 - Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me afat të pacaktuar.

Neni 4 – Objekti i shoqërisë

- 4.1 Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve tregtare në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi.
- 4.2 Në mënyrë më specifike, Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve vijuese:

Sherbime në fushën e konsulencës në fushën e auditimit, konsulencës fiskale financiare dhe juridike.



- 4.3 Konsulence ne fushen e agrobiznesit. Realizimi vete dhe per te trete i projekteve per zhvillim rural dhe bujqesor nepermjet asistences teknike dhe trajnimeve sherbimeve keshillmore sherbimeve te marketingut konsulences studimit e lidhjes dhe perpunimit statistikor te te dhenave. Aktiviteti i mesiperm kryhet ne menyre te pavarur dhe/ose ne bashkepunim me institucione e agjensi private dhe publike, vendase ose te huaja.
- 4.4 Shoqëria mund të kryejë çdo operacion tregtar, operacione që lidhen me pasuritë e luajshme dhe të paluajshme dhe hipotekore që lidhen me to, operacione financiare dhe kredimarrje, të japë garanci të tretëve si edhe të blejë dhe shesë ose marrë me qira ndërmarrje, degë ndërmarrjesh, si edhe të ketë pjesëmarrje në shoqëri, ente, konsorciume, të themeluara apo në themelim e sipër, që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm me të vetin apo gjithsesi funksional për arritjen e qëllimeve të shoqërisë. Më në përgjithësi, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të shoqërisë.

Neni 5 – Kapitali themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqindmijë) Leke.
- 5.2. Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 2 (dy) kuota, të gjitha të nënshkruara me vlerë sipas përcaktimit të nenit 6, si më poshtë.

Neni 6 - Kontributet

- 6.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë do të jetë si më poshtë:
- Z.Reni Ashiku do të ofrojë një kontribut në para në shumën prej 51.000 (pesëdhjetë e nje mijë/Leke) në favor të shoqërisë në themelim e sipër; dhe
 - Znj. Besarta Dika do të ofrojë një kontribut në para në shumën prej 49.000 (dyzet e nentëmijë/Leke) në favor të shoqërisë në themelim e sipër;
- 6.2 Sipas kontributeve të mësipërme:
- Z. Reni Ashiku përket 1 (një) kuotë, që i korrespondon 51% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë
 - Znj. Besarta Dika i përket 1 (një) kuotë, që i korrespondon 49% (dyzete nëntë përqind) të kapitalit të Shoqërisë.

Neni 7 – Transferimi i kuotave


Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

Neni 8 – Administrimi

- 8.1 Me këtë akt emërohet 1 (nje) Administrator të Shoqërisë i cili do të qëndrojë në detyrë për një periudhë prej 1 (nje) viti si më poshtë:

- **Reni Ashiku**, qytetar shqiptar, e lindur në Krujë, më 27.08.1978, me vendbanim në Rr. Myslym Shyri, Pallati 124, Ap 13 Tirane, Shqipëri, mbajtës e letërnjoftimit nr.029796552 dhe me numër personal H80827056E, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar,

I cili ka pranuar dhe deklaruar paraprakisht se në ngarkim të tij nuk ekziston asnjë pengesë ligjore për të mos u zgjedhur.



- 8.2 Administratori do të mund të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 95 të ligjit nr. 9901, datë 14 prill 2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe në çdo rast duke respektuar kufizimet e përcaktuara në këtë Akt Themelimi dhe/ose nga neni 14 i Statutit.
- 8.3 Administratorit I jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer formalitetet e përmbushjen e detyrimeve të parashikuara për themelimin e Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, Administratori, mund tu drejtohen për ndihmë të tretëve ose konsulentëve të cilëve mund të delegojnë në tërësi ose pjesërisht kryrjen e aktivitetit të sipërpërmendur.
- 8.4 Administratori gjithashtu gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Ata janë gjithashtu të autorizuar, të firmosin të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj si edhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tij personave të tjerë.


Neni 9 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve


- 9.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin, zbatimin dhe zgjidhjen e këtij akti themelimi dhe të statutit të shoqërisë, si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.
- 9.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen gjyqates se Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 10– Gjuha

- 10.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

Ky Akt Themelimi nënshkruhet lirisht nga palët me vullnetin e tyre të lire.


Z. Reni Ashiku


Znj. Besarta Dika